



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit

P-054

Prishtinë, më 18 shkurt 2009, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 18 SHKURT 2009

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slobodan Petroviq.

Nga Grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Muferra Sinik, Bojan Stojanoviç dhe Slavisha Pekoviç.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe tri pika shtesë. Kryesia miratoi propozimin e kryetarit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2009,
2. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2009**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2009, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare të radhës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca plenare e radhës të mbahet **më 26 shkurt 2009**, me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportimin financiar të organizatave të biznesit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore,
7. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Plani i veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë,
8. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008,
9. Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

### **3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Propozimi për rishpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit**

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Të rishpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në pajtim me Rregullat procedurale për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit t'i marrë të gjitha veprimet procedurale për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.
3. Konkursi të publikohet në shtypin ditor të Kosovës.

#### **3.2 Shqyrtimi i kërkesës së ish-deputetit Ramadan Kelmendi për ndihmë financiare**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

Miratohet kërkesa e ish-deputetit Ramadan Kelmendi për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit të syve deri në shumën prej pesëmijë (5.000) €.

#### **3.3 Njoftim i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport për funksionalizimin e Këshillit të Trashëgimisë**

Kryesia, pasi u njoftua me qëndrimin e Komisionit, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit të bisedojë me anëtarët e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore, për të funksionalizuar punën e këtij këshilli, në pajtim me Ligjin për trashëgiminë kulturore.

#### **3.4 Peticioni i Shoqërisë Civile kundër ngritjes së tarifës së energjisë elektrike**

Kryesia, pasi u njoftua me peticionin e cekur më lart, nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

Peticioni i Shoqërisë Civile kundër ngritjes së çmimit të energjisë elektrike t'i dërgohet Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë dhe Kuvendit t'ia paraqesin rekomandimet lidhur me të.

### **3.5 Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar ne Shqipëri**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

## **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Shqipëri, prej 22 deri më 25 shkurt 2009, në përbërje të deputetëve: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Shkumbin Demaliaj dhe Emrush Xhemajli.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**